

VENDIM
Nr. 167, datë 31.7.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 107, DATË 23.5.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË ‘DELIU 3D’ SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1385/15 prot., datë 25.7.2025, “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 23.5.2025, ka miratuar dhënie e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Banka OTP Albania” sh.a., duke përcaktuar ndër të tjera, që: Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj [....].

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, me shkresën nr. 1385/13 prot., datë 8.7.2025, i është drejtuar shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. me njoftimin për zbatimin e pikës 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, për dorëzimin pranë ERE të ekstraktit historik të përditësuar të regjistrit tregtar, pas pasqyrimit tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të kolateralit mbi kuotat, i cili ka për qëllim të vërtetojë, përmes dokumentacionit zyrtar, se vendosja e barrës siguruese mbi kuotat është regjistruar në regjistrin tregtar të QKB-së, në përputhje me autorizimin e dhënë nga ERE.

- Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k., me shkresën nr. 10/7 prot., datë 10.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1385/14 prot., datë 10.7.2025, ka përcjellë kopjen e ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë, ku reflektohet depozitimi në QKB i marrëveshjes siguruese nr. 1983 rep, nr. 1001 kol., datë 5.5.2025, për krijimin e një barre siguruese në favor të bankës “OTP Albania” sh.a., për krijimin e një barre të radhës së parë mbi çdo të drejtë, titull, interes të tyre mbi kuotat që përfaqësojnë 100% të kapitalit të nënshkruar të Barrëdhënësve në shoqërinë tregtare “Deliu 3D” sh.p.k.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Përditësimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. ka ndodhur në datën 20.6.2025 në tejkallim të afatit të përcaktuar në vendimarrjen e ERE-s. Në këto kushte, pavarësisht tejkallimit të afatit të sipërcituar, gjykojmë se me depozitim e dokumentacionit të sipërcituar, shoqëria ka plotësuar kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, duke qenë se qëllimi i vendosjes së kushtit ishte depozitimi i ekstraktit dhe tejkallimi i afatit nuk ka shkaktuar pasoja të cilat mund të cenonin ligjshmërinë e vendimit në tërësi, vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo tëshfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i

parashikuar shprehimisht me ligj, ku anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë, vlerësojmë që pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, duhet të shfuqizohet.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3, lind, gjithashtu, nevoja për ndryshimin e pikës 5 të po këtij vendimi, nga formulimi aktual: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi”, në: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5 e vendimit të BORDIT të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, ndryshon si vijon: “5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “DELIU 3D” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti